

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012. Ky përkthim u bë i mundur me mbështetjen e Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (www.coe.int/humanrightstrustfund). Ai nuk është detyrues për Gjykatën. Për më shumë informacion, shiko shënimin e plotë në lidhje me të drejtën e autorit në fund të këtij dokumenti.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). It does not bind the Court. For further information see the full copyright indication at the end of this document.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). Elle ne lie pas la Cour. Pour plus de renseignements veuillez lire l'indication de copyright/droits d'auteur à la fin du présent document.



COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME
EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

DHOMA E MADHE

ÇËSHTJA GUJA KUNDËR MOLDAVISË

(Kërkesë nr. 14277/04)

VENDIM

STRASBURG

12 Shkurt 2008

*Ky vendim është bërë përfundimtar, por ai mund t'i nënshtrohet
korrigjimeve.*

Në çështjen e Guja kundër Moldavisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Dhoma e Madhe me trup gjykues të përbërë pre:

Jean-Paul Costa, *President*,
Christos Rozakis,
Nicolas Bratza,
Boštjan M. Zupančič,
Peer Lorenzen,
Francoise Tulkens,
Giovanni Bonello,
Josep Casadevall,
Rait Maruste,
Kristaq Traja,
Snejana Botoucharova,
Stanislav Pavlovski,
Lech Garlicki,
Alvina Gyulumyan,
Ljiljana Mijović,
Mark Villiger,
Päivi Hirvelä *gjyqtarë*,
dhe Erik Friberg, *Kancelar*,

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 6 Qershor 2007 dhe 29 Qershor 2011,

Jep këtë vendim, i cili u mor në datën e fundit të lartpërmendur:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të kërkesës (nr. 28955/06, 28957/06, 28959/06, 28964/06, 28389/06 dhe 28961/06), kundër Republikës së Moldavisë drejtuar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga Z. Iacob Guja ("kërkuesi"), më 30 Mars 2004..

2. Kërkuesi u përfaqësua nga Z. V. Gribincea dhe Z. V. Zamă, avokatë që e ushtrojnë profesionin e tyre në Chisinau dhe njëkohësisht anëtarë të organizatës jo-qeveritare "Juristët e të Drejtave të Njeriut". Qeveria Moldave ("Qeveria") u përfaqësua nga agjentët e saj Z. V. Pârlog dhe Z. V. Grosu.

3. Kërkuesi pretendoi shkelje të drejtës së tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të Konventës, në veçanti të drejtën për të dhënë informacion, si rezultat i shkarkimit të tij nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm për bërjen publike të dy dokumenteve të cilat sipas mendimit të tij tregonin, ndërhyrje nga një politikan i rangut të lartë në zhvillimin e një procedure penale.

4. Ankimi iu dha për gjykim Seksionit të katërt të Gjykatës (Rregulli 52 § 1 i Rregullores së Gjykatës). Më 28 mars 2006, një Dhomë e atij Seksioni vendosi t'ia komunikonte kërkesën e paraqitur Qeverisë. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës ajo vendosi të shqyrtojë themelin e ankimit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e saj. Më 20 shkurt 2007 Dhoma e përbërë nga Nicolas Bratza në cilësinë e Presidentit, gjyqtarët Josep Casadevall, Giovanni Bonello, Ljiljana Mijović, Kristaq Traja, Stanislav Pavlovski, Lech Garlicki dhe Kancelari i Seksionit Lawrence Early, hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe dhe asnjë nga palët nuk e kundërshtoi këtë. (neni 30 i Konventës dhe neni 72 i Rregullores së Gjykatës)

5. Përbërja e Dhomës së Madhe u përcaktua në përputhje me dispozitat e nenit 27 §§ 2 dhe 3 të Konventës dhe nenit 24 të Rregullores së Gjykatës.

6. Kërkuesit dhe Qeveria paraqitën pretendimet me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelin e kërkesës. Palët iu përgjigjën me shkrim pretendimeve të njeri-tjetrit.

7. Seanca publike gjyqësore u zhvillua në Pallatin e të Drejtave të Njeriut, në Strasburg më 6 Qershor 2007 (neni 59 § 3 i Rregullores së Gjykatës).

U paraqiten përpara Gjykatës:

(a) *për Qeverinë*

Z. V. GROSU,
Z. G. ZAMISNÎI,

*Agjent,
Këshilltar;*

(b) *për kërkuesin*

Z. V. GRIBINCEA,
Z. V. ZAMĂ, *Counsel*,
Z. I. GUJA,

Kërkues.

Gjykata dëgjoi parashtresat nga Z. Grosu, Z. Gribincea dhe Z. Zamă.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

8. Kërkuesi, Z. Jakob Guja, ka lindur në vitin 1970 dhe jeton në Kishinau. Në atë kohë ai ishte Drejtor i Departamentit të Shtypit i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

1. Historiku i çështjes

9. Më 21 shkurt 2002, katër oficerëve të policisë (M.I., B.A., I.P. dhe GV) arrestuan dhjetë persona të dyshuar për vepra që kanë të bëjnë me zgjedhjet parlamentare; njëri prej tyre dyshohej se drejtonte një bande kriminale. Pas lirimit nga paraburgimi, të dyshuarit paraqiten një ankim në Prokurori për keqtrajtim dhe arrestim të paligjshëm nga katër oficerët e policisë. Me paraqitjen e ankimit, nisi një hetim penal kundër policëve të akuzuar për, *inter alia*, keqtrajtim dhe arrest të paligjshëm.

10. Në qershor të vitit 2002, katër oficerët e policisë i drejtuan letër të nënshkruar nga të gjithë ata, Presidentit Voronin, Kryeministrit Tarlev dhe Zëvendës Kryetarit të Parlamentit Mişin, në të cilën kërkonin mbrojtje nga ndjekja penale, që kishte nisur kundra tyre. Ata shprehen vërejtjet e tyre mbi procedurat penale duke pretenduar se veprimet e Prokurorisë ishin abuzive. Ata kërkuan verifikimin e ligjshmërisë të akuzave penale kundër tyre. Më 21 qershor 2002, Z. Mişin ia përcolli letrën që ai kishte marrë, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm me një shënim shoqërues. Shënimi ishte shkruar në letër me stemën zyrtare të Parlamentit dhe nuk klasifikohej si konfidenciale. Në të shkruhej si më poshtë:

“I dashur Z. Rusu,

Një pyetje më lindi pasi lexova këtë letër: Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm po lufton krimin apo policinë? Kjo çështje është bërë edhe më e ngutshme për faktin se oficerët e policët në fjalë janë një nga ekipet më të mira në Ministrinë e Punëve të Brendshme, aktiviteti i të cilëve tani është pezulluar, si rezultat i veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Unë kërkoj nga ju që të përfshihen personalisht në këtë çështje, për ta zgjidhur atë në përputhje të plotë me ligjin.”

11. Në janar 2003 Z. Voronin bëri një vizitë në Qendrën për Luftën ndaj Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, gjatë së cilës ai diskutoi, ndër të tjera, problemin e presionit të zyrtarëve publikë ndaj organeve të zbatimit të ligjit në lidhje me procedimet penale ende të pazgjidhura. Presidenti ju bëri thirrje, organeve të zbatimit të ligjit, për të luftuar korrupsionin pavarësisht përpjekjeve nga zyrtarët publikë për t'i vënë ato nën presion. Deklaratat e Presidentit u bënë publike nga media.

12. Në një datë të paspecifikuar procesi penal kundër oficerëve të policisë pushoi.

2. Dalja e dokumenteve

13. Disa ditë pasi Z. Voronin bëri thirrjen e tij për të luftuar korrupsionin, kërkuesi dërgoi në një gazetë “Jurnal de Chişinău”, kopjet e dy letrave (“letrat”) që ishin dërguar Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

14. E para ishte shënimi i shkruar nga Z. Mişin (shih paragrafin 10 më lart). Letra e dytë ishte shkruar nga Z. A. Ursachi, zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe i drejtohej Zëvendës Prokurorit të

Përgjithshëm. Ajo shkruhej në letër zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nuk ishte klasifikuar konfidenciale. Në të, *inter alia*, thuhej

“...Polic Majori M.I. [një nga katër oficerët: shih paragrafin 9 më lart] u dënua më 12 maj 1999 ... për veprat penale sipas neneve 116 (2) [ndalim i paligjshme duke rrezikuar jetën, shëndetin ose shkaktimin e vuajtjeve fizike], 185 (2) [abuzim me detyrën, shoqëruar me akte dhune, përdorim të mjeteve të zjarrit ose torturës] dhe 193 (2) [marrja e dëshmisë me anë të dhunës dhe kanosjes] të Kodi Penal dhe u dënua me gjobë prej 1440 lei moldave (monedha Moldave (MDL), (në euro 128 €). Sipas nenit 2 të Ligjit për Amnistinë, ai u çlirua nga detyrimi për pagimin e gjobës.

... më 24 tetor 2001, majori M.I. u rikthye në postin e tij në Ministrinë e Punëve të Brendshme.”

3. Artikulli i botuar në “Jurnal de Chişinău

15. Më 31 janar 2003, *Jurnal de Chişinău* botoi një artikull me titull: "Vadim Mişin frikëson prokurorët". Artikulli ndër të tjera shkruante

“Në fund të javës së kaluar, gjatë një takimi në Qendrën për Luftën e Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit, Presidenti u bëri thirrje institucioneve të zbatimit të ligjit që të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe u kërkoi atyre që të inorojnë thirrjet telefonike nga zyrtarët e lartë publikë lidhur me çështjet që ishin në pritje para tyre.

Nisma e Presidentit nuk është e rastësishme. Fenomeni është bërë shumë i përhapur, sidomos gjatë viteve të fundit, dhe ka qenë subjekt i një debati në media dhe nga organizatat ndërkombëtare.

Kohët e fundit shtypi raportoi mbi rastin e parlamentarit komunist A.J., i cili kishte tentuar të influenconte në një hetim penal në lidhje me një mik të vjetër të tijin, ky i fundit zyrtar i lartë në Ministrinë e Bujqësisë e kapur në flagrancë. Megjithatë, asnjë veprim ligjor nuk u ndërmor. ...

Gjithashtu, shtypi raportoi se, zoti Mişin i kishte kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm për të shkarkuar dy prokurorë, I.V. dhe P.B. të përfshirë në hetimin e zhdukjes së Shefit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, P.D., të cilët me sa duket kishin gjetur prova që implikonin zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Rezultatet e hetimeve të brendshme për aktivitetet e këtyre dy prokurorëve nuk janë të njohura ende. Megjithatë, burime nga zyra e Prokurorisë, thanë për këtë gazetë se edhe pse I.V. dhe P.B. nuk janë gjetur fajtorë, atyre u është kërkuar largimi nga dikush me pushtet.

Ndërkohe që deklaratat e Presidentit në lidhje me influencën nga zyrtarë të lartë, janë ende të freskëta, ne kemi zbuluar një hetim të ri lidhur me zyrtarë të lartë.

Zëvendës Kryetari i Kuvendit po përpiqet të mbrojë katër policë të cilët janë nën hetim penal. Lidhjet e Z. Mişin me policinë nuk janë diçka e re, pasur parasysh rrënjët e tij janë në Forcat e Policisë. Nga burimet tona tregohet se ky nuk është rasti i vetëm në të cilin zoti Mişin ka ndërhyrë në mbrojtje të policëve në telashe me ligjin.

...

Prokuroria e Ciocana kishte iniciuar proces penale kundër katër oficerëve të policisë ... pasi ata kishin përdorur forcë gjatë arrestimit të paligjshëm të një grupi njerëzish.

... Policët sulmuan të burgosurit me grushte dhe shkelma... Për më tepër, një nga oficerët kishte bërë deklaratatë të rreme në raportin e policisë për arrestimin ... Katër policë po hetoheshin gjithashtu për marrje të dëshmisë me forcë...

Hetimi zgjati për më shumë se një vit. Kur ai ishte pothuajse në përfundim ... policët kërkuar mbrojtje nga ata që janë në pushtet.

...

Më 20 qershor 2002, oficerët e policisë shkruan një letër drejtuar Presidentit Vladimir Voronin, Kryeministrit Vasile Tarlev dhe Zëvendës Kryetarit të Parlamentit, Vadim Mişin, duke u kërkuar atyre që të ndërhyjë për t'i dhënë fund hetimeve, sipas tyre të pajustificuara.

...

I pari që reagoi ndaj letrës së tyre ishte Zv Kryetari i Kuvendit, Vadim Mişin. Më 21 qershor 2002 ... ai i dërgoi Prokurorit të Përgjithshëm një letër, në të cilën, me një ton komandues, ai i kërkoj atij personalisht të ndërhyjë në rastin e katër policëve. Edhe pse ai e udhëzoi Prokurorit të Përgjithshëm për t'u përfshirë në këtë çështje", në përputhje të plotë me ligjin", toni i letrës tregon qartë se ai po urdhëronte shqyrtimin e shpejtë të çështjes.

Si rezultat i ndërhyrjes së figurave të rëndësishme shtetërore me influencë, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ndërpreu hetimet kundër policëve dhe urdhëroi një hetim të brendshëm për korrektësinë e vendimit për të nisur procedurën penale kundër tyre...

...

... Burime nga Ministria e Punëve të Brendshme kanë konfirmuar se zyrtari M.I. [Një nga katër policët] ishte dënuar më parë nga Gjykata e Apelit, e cila e kishte urdhëruar të paguante një gjobë prej 1440 MDL. Në përputhje me Ligjin për Amnistinë, ai ishte çliruar nga detyrimi për pagimin e gjobës. Për më tepër, më 24 tetor 2001 ... ai u rikthye në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Pa dashur të komentojmë mbi vendimin e Gjykatës së Apelit, ne dëshirojmë që të bëjmë disa vërejtje. M.I. u dënua në bazë të neneve 116, 185 dhe 193 të Kodit Penal për abuzimit të pushtetit, marrja e dëshmimeve me forcë dhe ndalime të paligjshme. Për këto vepra, Kodi Penal përcakton dënime me burgim 1-5 vjet. Atij iu dha vetëm një gjobë.

Për më tepër, Ministria e Punëve të Brendshme e riktheu atë në detyrë, ndërsa ai ishte ende nën hetim."

16. Artikulli i gazetës u shoqërua me fotot e letrave të nënshkruara nga Z. Mişin dhe Z. Ursachi.

4. Reagimi kundër së Prokurorit të Përgjithshëm

17. Në një datë të paspecifikuar kërkuesit iu kërkua nga Prokurori i Përgjithshëm, të përgjigjej për të faktin se si dy letra kishin rënë në duar të medias.

18. Më 14 shkurt 2003 kërkuesi i shkroi Prokurorit të Përgjithshëm, ku i pranonte se kishte qenë ai që i kishte dërguar dy letrat gazetës. Ai deklaronte *inter alia*:

“Akti im ishte një reagim ndaj deklaratave të bëra nga Presidenti, në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.. Unë e bëra këtë, sepse isha i bindur se po ndihmoja luftën kundër shpërdorimit të detyrës (trafic de influență), një fenomen gjithnjë e më i zakonshme kohët e fundit.

Kam besuar dhe ende besoj se, nëse secili prej nesh do të ndihmojë për të demaskuar ata që abuzojnë me pozitën e tyre në mënyrë që të pengojnë drejtësinë, situata do të ndryshojë për të mirë.

Më tej, letra që kam dorëzuar në Jurnal de Chișinău nuk ishin sekrete. Synimi im nuk ishte për të dëmtuar Prokurorinë, por për të krijuar një imazh pozitiv të saj.”

19. Në një datë të paspecifikuar prokurori I.D., i cili dyshohej se i kishte dhënë letrat kërkuesit, u shkarkua.

20. Më 17 shkurt 2003 kërkuesi i shkroi një letër Prokurorisë së Përgjithshme duke i bërë me dije se letrat nuk ishte marrë nga I.D. Ai shtoi:

“Nëse mënyra në të cilën kam vepruar konsiderohet një shkelje e rregullave të brendshme, atëherë jam unë ai që duhet të mbaj përgjegjësi.

Unë kam vepruar në përputhje me Ligjin për Akses në Informacion, Ligjin për Prokurorinë dhe Kodin Penal. Unë besoja se, deklaratat e Presidentit që dënonin aktet e korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës ishin të sinqerta. Me keqardhje të madhe, vërej sesi Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm letrën nga një zyrtar publik (i cili për mendimin tim është një shembull i qartë i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të politikës në administrimin e drejtësisë) e ngriti në statusin e Sekretit Shtetëror. Ky fakt, së bashku me shkarkimin I.D.-së, më shqetësojnë dhe më bëjnë të dyshoj seriozisht për sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Moldavisë.”

21. Më 3 mars 2003, kërkuesi u shkarkua nga detyra. Në urdhrin e shkarkimit deklarohet, *inter alia*, se letrat e publikuara nga kërkuesi në gazetë ishin sekrete dhe se ai nuk ishte konsultuar më parë me krerët e drejtorive të tjera të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, në shkelje të neneve 1.4 dhe 4.11 të Rregullores së Brendshme të Departamentit të Shtypit (shih paragrafin 31 më poshtë)

5. Procedurat për rikthimi në detyrë nga kërkuesi

22. Më 21 mars 2003, kërkuesi ngriti një padi civile ndaj Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm ku kërkonte rikthimin në detyrë. Ai argumentoi, ndër të tjera, se letrat e publikuara në gazetë nuk ishin klasifikuar si sekrete, në përputhje me ligjin, se ai nuk ishte i detyruar të konsultohet me krerët e

drejtorive të tjera para se të kontaktonte shtypin, që ai i kishte dhënë letrat gazetës me kërkesë të kësaj të fundit, dhe se shkarkimi i tij përbënte shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

23. Më 16 shtator 2003, Gjykata e Apelit e Kishinau hodhi poshtë padinë e kërkuarit. Ajo deklaroi, *inter alia*, se kërkuari kishte shkelur detyrimet e tij sipas paragrafit 1.4 të Rregullores së Brendshme të Departamentit të Shtypit duke mos u konsultuar me shefat e departamenteve të tjera, dhe sipas paragrafit 4.11 të Rregullores duke nxjerrë dokumente sekrete.

24. Kërkuari apeloj. Ai u mbështet në të njëjtat argumente si në padinë e tij të parë. Ai gjithashtu argumentoi se nxjerrja e letrave në gazetë nuk paragjykonte në asnjë mënyrë punëdhënësin e tij.

25. Më 26 nëntor 2003, Gjykata e Lartë e Drejtësisë hodhi poshtë ankimin në baza të njëjta si në Gjykatën e Apelit të Kishinau. Duke iu referuar pretendimeve të kërkuarit në lidhje me lirinë e shprehjes, Gjykata e Lartë deklaroi se marrja e informacionit nga dikush i cili abuzon me pozitën nuk ishte pjesë e lirisë së shprehjes (*dreptul la exprimare nu presupune dobândirea informației abuziv, folosind atribuțiile de serviciu*).

26. As Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe as Zëvendës Kryetari i Parlamentit Z. Mișin, nuk kanë kundërshtuar vërtetësinë e letrave të botuara në *Jurnal de Chișinău* ose vërtetësinë e informacionit që përmbante artikulli i botuar më 31 janar 2003 apo të kenë ndërmarrë ndonjë veprim të mëtejshëm.

6. Padia penale nga Jurnal de Chișinău

27. Duke qenë se Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, pas botimit të artikullit në 31 janar 2003, nuk reagoi ashtu si *Jurnal de Chișinău* kishte parashikuar (shih paragrafin 15 më sipër), kjo e fundit nisi procedurat gjyqësore për nxjerrjen e një urdhri që i kërkonte Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për të filluar hetimin penal në lidhje me ndërhyrjen nga Z. Mișin në një hetim penal në zhvillim. Gazeta argumentoi, ndër të tjera, që sipas Kodit të Procedurës Penale, artikujt e gazetave dhe letrat e botuara në gazeta, mund të shërbejnë si bazë për fillimin e procedurës penale dhe se Prokurori i Përgjithshëm kishte detyrimin të urdhëronte një hetim.

28. Kërkesa e paraqitur nga gazeta u rrëzua nga Gjykata e Qarkut Râșcani më 25 mars 2003 dhe nga Gjykata Rajonale Kishinau në 9 prill 2003. Gjykatat gjetën, *inter alia*, se gazeta nuk ka të drejtë ligjore për të paraqitur një ankesë dhe se, në çdo rast, artikulli i 31 janar 2003, ishte thjesht një artikull gazete ku shpreheshin pikëpamje personale, dhe jo një kërkesë zyrtare për të filluar një hetim penal.

7. *Artikulli pasues nga Jurnal de Chişinău*

29. Më 14 mars 2003 Jurnal de Chişinău botoi një artikull që pasonte artikullin e saj të datës 31 janar 2003, me titull "Misin ka nisur goditjen ndaj prokurorëve". Në atë artikull përshkruheshin ngjarjet që kishin pasuar botimin e artikullit të parë dhe gjithashtu thuhej se Z. Mişin ishte zemëruar nga artikulli dhe kishte urdhëruar Prokurorin i Përgjithshëm për të identifikuar dhe ndëshkuar përgjegjësit për bërjen publike në shtyp të shënimit të tij. Prokurori i Përgjithshëm u bind dhe i shpalli luftë vartësve të cilët nuk toleronin ndërhyrjet politike në punët e sistemit të drejtësisë penale. Në artikull, thuhej me tej se veprimet e Prokurorit të Përgjithshëm ishin në përputhje me një tendencë të përgjithshme që vërehej vitet e fundit duke zëvendësuar punonjësit me përvojë të konsiderueshme profesionale të cilët nuk ishin të përgatitur për të respektuar rregullat e vendosura nga Qeveria e re, me të tjerë me prejardhje të dyshimta. Për më tepër shkruhej, se nga burime të brendshme nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm pohohej se Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm kishte marrë indikacione sistematike nga Z. Mişin dhe këshilltarët të Presidentit, lidhur me punësimin apo shkarkimin e personave të punësuar. Vetëm vitin e kaluar, tridhjetë prokurorë me përvojë ishin larguar nga Zyra e Prokurorit të Kishinau.

Artikulli gjithashtu shpjegonte shkarkimin e kërkuesit, si rezultat i presionit nga Z. Mişin, dhe deklaronte se nga burimet në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm thuhej se Zyra e Prokurorit kishte marrë dhjetëra letra nga Z. Mişin dhe V.S (një tjetër zyrtar i lartë publik), në lidhje me hetimet penale.

Sipas burimeve të gazetës, dy prokurorë ishin larguar me këmbënguljen e Z. Mişin sepse ata kishin zbuluar materiale që e ngarkonin atë me përgjegjësi, gjatë një hetimi për zhdukjen e një biznesmeni të rëndësishëm me inicialet P.D. Pas shkarkimit të tyre procedimi penal ishte mbyllur.

II. AKTET PËRKATËSE QË NUK I PËRKASIN KONVENTËS

A. E drejta dhe praktika vendase

1. *Kodi i Punës*

30. Neni 263/1 i Kodit të Punës, parashikonte se punonjësit e autoriteteve publike qendrore mund të shkarkohen për shkelje të rënda të detyrave të tyre profesionale.

2. Rregullore e brendshme të Departamentit të Shtypit në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm

31. Nenet 1.4 dhe 4.11 të Rregullores së Brendshme të Departamentit të Shtypit të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm citojnë si vijon:

“1.4 Departamenti për shtyp do të planifikojë dhe organizojë, në bashkëpunim me zyrat editoriale të gazetave, revistave, dhe stacionet radiofonike dhe televizive si dhe me drejtuesit e departamenteve të tjera të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, artikuj për publikim në media në lidhje me aktivitetet e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

...

4.11 [Shef i Departamentit të Shtypit] është përgjegjës për cilësinë e materialeve të publikuara, vërtetësinë e informacionit të marrë dhe të përcjellë dhe për ruajtjen e konfidentalitetit në përputhje me legjislacionin e Republikës së Moldavisë”.

32. Në atë kohë as Rregulloret e Brendshme të Zyrës së Prokurorit e as legjislacionin moldav në përgjithësi, nuk përmbante ndonjë dispozitë në lidhje me raportimin nga punonjësit, për parregullsi që vërenin në vendin e tyre të punës.

3. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

33. Kodi Penal në atë kohë përmbante dispozitën 190/1 që ndalonte çdo ndërhyrje në një hetim penal. Në të parashikohej si vijon:

“Çdo ndërhyrje në një hetim penal, përkatësisht ushtrim i ndikimit në mënyrë të paligjshme në çfarëdo lloj forme mbi personin që kryen hetimin ... dënohet me burgim deri në dy vjet ose me gjobë deri në njëqind herë shumën e pagës pagën minimale.”

34. Neni 90 i Kodit të Procedurës Penale në atë kohë parashikonte që, *inter alia*, informacionet në artikujt e gazetave apo shënimet e letrave të botuara në një gazetë lidhur me veprat penale, mund të përbëjnë bazë për një prokuror të fillojë një hetim penal.

35. Neni 122 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se në fazën e hetimit penal, materialet nga dosja penale nuk mund të bëhen publike, përveç me autorizim të personit përgjegjës për hetimin.

4. Organizimi i Institucionit të Prokurorisë në Moldavi

36. Sipas neni 125 të Kushtetutës, prokurorët janë të pavarur.

37. Dispozitat pertinente të Ligjit për Autoritetin e Prokurorisë parashikojnë si më poshtë:

“Neni 3. Parimet themelore që rregullojnë veprimtarinë e Prokurorisë

1. Prokuroria:

- Ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nga autoritetet publike ... në përputhje me ligjin; ...

3. ... Prokurorët dhe hetuesit ... përjashtohen nga anëtarësimi në ndonjë parti politike ose organizata të tjera social-politike dhe përgjigjen para ligjit...”

“Neni 13. Prokurori i Përgjithshëm

1. Prokurori i Përgjithshëm:

(i) emërohet nga Kuvendi me propozim të Kryetarit të Kuvendit, për një mandat 5 vjeçar; dhe

(ii) ka dy zëvendës Prokurorë të Përgjithshëm, njëri i lartë dhe tjetri i zakonshëm, të cilët emërohen nga Kuvendi me propozimin e tij...”

5. Ligji për Peticionet dhe Ligji për Statusin e Deputetëve

38. Ligji për Peticionet kërkon nga nëpunësit civilë apo organet qeveritare t’i përgjigjen kërkesave të shkruara brenda një afati tridhjetë ditor. Nëse ata nuk kanë kompetenca, duhet t’ia kalojnë kërkesën organit kompetent brenda tri ditëve.

39. Ligji për Statusin e Deputetëve lidhur me këtë citon si më poshtë tw 7 prill 1994 parashikon:

Neni 22(1)

“Deputetët kanë të drejtë të kontaktojnë çdo organ shtetëror, organizatë joqeveritare ose zyrtar, lidhur me probleme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e një deputeti dhe të marrin pjesë në shqyrtimin e tyre.”

Neni 23

“(1) Deputetët në cilësinë e përfaqësuesve të organit ligjvënës, kanë të drejtë të kërkojnë ndalimin e çdo veprimi të jashtëligjshëm. Kur është e nevojshme, mund të kërkojnë nga strukturat zyrtare apo personat zyrtar, ndërhyrjen për ndalimin e një veprimi të jashtëligjshëm...”

B. Raportet në lidhje me ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e gjyqësorit në Moldavi

40. Në raportin e vitit 2004 të Komisionit Ndërkombëtar të Juristëve (KNJ) lidhur me shtetin e së drejtës në Moldavi thuhet:

“...Misioni në Moldavi i ndërmarrë nga Qendra për Pavarësinë e Gjyqtarëve dhe Juristëve të Komisionit Ndërkombëtar të Juristëve (KNJ / QPGJ) ka arritur në përfundimin se, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga Qeveria Moldave e post-pavarësisë, për të reformuar sistemin e saj të drejtësisë, shteti i së drejtës vuan mangësi serioze që duhet të trajtohen. KNJ / QPGJ vërejtë se ndarja e pushteteve vuan në një masë të madhe nga nënshtrimi i gjyqësorit ndaj diktatit të Qeverisë. Praktika e “drejtësisë me telefon” është rikthyer. Ekzekutivi është në gjendje të influencojë ndjeshëm emërimet e gjyqësorit nëpërmjet Këshillit të Lartë të

Magjistraturës, të cilit i mungon pavarësia. Përtej akuzave të korrupsionit, sistemi gjyqësor në Moldavi ka bërë ndjeshëm hapa mbrapa në tre vitet e fundit, duke rezultuar në marrjen e vendimeve gjyqësore që mund të shtrembërojnë kursi i drejtësisë, kur interesat e Qeverisë janë në lojë....”

41. Raporti i vitit 2003 i “Shtëpia e Lirisë” (Freedom House), lidhur me Moldavinë ka deklaruar, *inter alia*, se:

“...Në vitin 2002, parimi i shtetit të së drejtës kishte probleme në Moldavi ... Gjithashtu duke ndikuar në balancën e brishtë ndërmjet pushteteve legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, në vitin 2002 pati një sërë emërimesh gjyqësore në bazë të besnikërisë ndaj partisë në pushtet, shkarkimi i Avokatit të Popullit, dhe përpjekjet për të kufizuar pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese ... Në prill 2002, Shoqata Moldave e Gjyqtarëve (MAJ) sinjalizoi se qeveria kishte filluar një proces të "spastrimit masiv" në sistemin gjyqësor. Shtatë gjyqtarë humbën punën e tyre. ...Situata u përkeqësua kur presidenti Voronin refuzoi të zgjasë mandatet e 57 gjyqtarëve të tjerë...”

42. Raporti i 2003 nga Nisma e Shoqërisë së Hapur për Drejtësinë (Open Society Justice Initiative) dhe “Shtëpia e Lirisë” (Freedom House) Moldavi ka deklaruar, *inter alia*, si vijon:

“...ishte krijuar praktika e “marrjes nën kontroll” të dosjeve të çështjeve të caktuara, që paraqisnin interes për udhëheqësit komunistë ose autoritetet shtetërore. Kjo praktikë funksiononte si më poshtë: Këshilli i Lartë i Magjistraturës (KLM) ose Gjykata e Lartë (dy institucionet drejtohen nga i njëjti person) merr udhëzime nga zyra e Presidentit, Qeveria apo Parlamenti, lidhur me çështjet në fjalë dhe zgjidhjen që kërkohet (udhëzime të tilla ekzistojnë edhe verbalisht). Pas këtyre udhëzimeve, Gjykata e Lartë ose KLM i drejtohet kryetarit të gjykatës, ku do shqyrtohet dosja, duke e urdhëruar që të "marrë nën kontroll personalisht" ekzaminimin e një apo disa çështjeve të veçanta. E ashtuquajtura "marrje nën kontroll" në fakt nënkupton udhëzime të drejtpërdrejta, në lidhje me zgjidhjet që duhet t'u jepeshin çështjeve të veçanta.”

C. Materiale nga Kombet e Bashkuara

43. Konventa për Ndërprerjen e Marrëdhënieve të Punës nr. 158 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e cila është ratifikuar nga Moldavia më 14 shkurt 1997, lidhur me çështjen në fjalë parashikon si më poshtë:

Neni 5

“Nuk përbën, *inter alia*, arsye të vlefshme për ndërprerje:

...

(c dorëzimi i një ankimi ose pjesëmarrja në procedurën kundër një punëdhënësi lidhur me shkeljen e pretenduar të ligjeve ose rregullave dhe ankimi te autoritetet kompetente administrative;

...”

44. Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën nr. 58/4 të datës 31 tetor 2003 dhe që ka hyrë në fuqi që më 14 dhjetor 2005, thuhet lidhur me çështjen në fjalë si më poshtë:

Neni 33

“Mbrotjtja e personave raportues

Secili nga Shtetet Palë duhet të marrë në konsideratë përfshirjen në sistemin e brendshëm juridik të masave të përshtatshme për të siguruar mbrotjtje nga çdo trajtim i padrejtë i personave që raportojnë në mirëbesim dhe mbi baza të arsyeshme pranë autoriteteve kompetente fakte, që lidhen me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.”

Në datën në të cilën ky vendim u mor, Konventa ishte nënshkruar nga 140 vende dhe ishte ratifikuar e pranuar me aderim nga 77 vende, duke mos përfshirë Republikën e Moldavisë.

C. Materiale nga Këshilli i Evropës

45. Konventa Penale e Këshillit të Evropës për Korrupsionin e 27 janarit 1999 lexon si vijon:

“Hyrtje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese të saj,

...

Duke theksuar se korrupsioni dëmton shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, ul nivelin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe drejtësisë shoqërore, pengon konkurrencën, zhvillimin ekonomik dhe rrezikon qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike dhe themeleve morale të shoqërisë;

...

Kanë pranuar si vijon:

...

Neni 22 - Mbrotjtja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe dëshmitarëve

Secila Palë do të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme, për të siguruar mbrotjtje efektive dhe të përshtatshme për:

a. ata që raportojnë veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 14 ose që bashkëpunojnë me autoritetet hetimore ose proceduese;

b. dëshmitarë që dëshmojnë lidhur me këto vepra.”

Raporti shpjegues i Konventës lidhur me nenin 22, sqaron:

“111. ... termi “dëshmitarë” i referohet personave që posedojnë informacione të rëndësishme për procesin penal në lidhje me veprat penale të korrupsionit të përfshira në nenet 2 - 14 të Konventës dhe përfshin informatorët.”

Kjo Konventë u nënshkrua nga Moldavia më 24 Qershor 1999 dhe hyri në fuqi më 1 Maj 2004.

46. Konventa Civile e Këshillit të Evropës për Korrupsionin, parashikon si më poshtë:

“Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, shtete të tjera dhe Komuniteti Evropian, nënshkruese të kësaj Konvente,

...

Duke theksuar që korrupsioni përfaqëson një rrezik të madh për shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pastërtinë dhe drejtësinë sociale, që pengon zhvillimin ekonomik dhe rrezikon funksionimin e drejtë dhe të duhur të ekonomisë së tregut;

Duke njohur pasojat e dëmshme financiare të korrupsionit ndaj individëve, kompanive dhe shteteve, si dhe ndaj institucioneve ndërkombëtare;

...

Bien dakord si më poshtë:

...

Neni 9 - Mbrojtja e punonjësve

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar mbrojtjen e duhur ndaj çdo sanksioni të pajustificuar ndaj punonjësve të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion dhe që këtë dyshim ia paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve.”

Raporti shpjegues i Konventës në lidhje me Nenin 9 shprehet si vijon:

“66. Ky nen merret me nevojën për marrjen e masave të nevojshme, nga secila palë, për të mbrojtur punonjësit, të cilët raportojnë në mirëbesim dhe mbi baza të arsyeshme dyshimet e tyre mbi praktikat korruptive apo sjelljet, nga të qenit viktimë.

67. Sa i përket masave të nevojshme për të mbrojtur punonjësit e parashikuara nga Neni 9 i Konventës, Palët nëpërmjet legjislacionit të brendshëm, për shembull, mund që të sigurojnë detyrimin e punëdhënësit për t'i paguar kompensim punonjësve të cilët janë viktimë të sanksioneve pajustificuara.

68. Në praktikë rastet e korrupsionit janë të vështira për tu zbuluar dhe hetuar dhe punonjësit apo kolegët (publike ose private) të personave të përfshirë, janë shpesh personat e parë të cilët zbulojnë ose dyshojnë se diçka është e gabuar.

69. Mbrojtja e duhur ndaj çdo sanksioni të pajustificuar” nënkupton që, në bazë të kësaj Konvente, çdo sanksion ndaj punonjësve të cilët raportojnë një akt korrupsioni tek personat apo autoriteteve përgjegjëse për marrjen e raporteve të tilla, për shkak të

këtij raportimi, nuk do të jetë i justifikuar. Raportimi nuk duhet konsideruar si shkelje e detyrimit për konfidencialitet. Shembuj të sanksioneve të pajustificuara mund të jenë shkarkimi, ulja në detyrë ose duke vepruar në një mënyrë të tillë që kufizon përparimin e tyre në karrierë.

70. Duhet të bëhet e qartë se, edhe pse askush nuk mund të parandalojë punëdhënësin të marrë çdo veprim të nevojshëm ndaj punonjësve të tij në përputhje me dispozitat përkatëse (p.sh. në fushën e së drejtës së punës) të zbatueshme për rrethanat e rastit në fjalë, punëdhënësi nuk duhet të sanksionojë në mënyrë të pajustificuar punonjësit vetëm se këta të fundit kanë raportuar dyshimet e tyre pranë personit ose autoriteti përgjegjës.

71. Prandaj, mbrojtja e duhur që Palët duhet të sigurojnë inkurajojnë punonjësit për të raportuar dyshimet e tyre pranë personin ose autoriteti përgjegjës. Në të vërtetë, në shumë raste, personat që kanë informacion të aktiviteteve korruptive nuk i raportojnë ato, kryesisht për shkak të frikës nga pasojat e mundshme negative.

72. Sa i përket punonjësve, kjo mbrojtje u ofrohet me kusht që raportimet e tyre të jenë mbi baza të arsyeshme dhe veprojnë me mirëbesim. Me fjalë të tjera, kjo vlen vetëm për rastet e raportimeve të vërteta dhe jo kur ato bëhen me qëllim të keq.”

Kjo Konventë u nënshkrua nga Moldavia më 4 Nëntor 1999 dhe hyri në fuqi më 1 Korrik 2004.

47. Rekomandimi mbi Kodet e Sjelljes për Funkionarët Publikë miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 11 maj 2000 (Rec. (2000) 10), për aq sa lidhet me çështjen në fjalë, thotë:

“Neni 11

Duke pasur parasysh të drejtën e informimit për dokumente zyrtare, funksionari publik ka për detyrë për të trajtuar siç duhet, me gjithë konfidencialitetin e nevojshëm, të gjitha informatat dhe dokumentet e marra prej tij ose të saj si rrjedhojë e punësimit ose gjatë procesit për marrjen në pune.

Neni 12 - Raportimi

...

5. Funksionari publik duhet të raportojë tek autoritetet kompetente çdo fakt, pretendimi ose dyshimi për aktivitete të paligjshme ose kriminale lidhur me shërbimin publik, për të cilat ai vihet në dijeni gjatë kryerjes, ose për shkak të detyrës publike. Hetimi i fakteve të raportuara duhet të kryhet nga autoritetet kompetente.

6. Administrata publike duhet të sigurojë që asnjë zyrtar publik i cili i raporton për sa me lart përmendet, mbi baza të arsyeshme dhe me mirëbesim të mos paragjykohet.”

E DREJTA

48. Kërkuesi pretendonte se shkarkimi i tij si rrjedhojë e vënies në dispozicion për *Jurnal de Chişinău* të letrave të kundërshtuara, përbente shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes dhe në veçantit të së drejtës për të dhënë informacione dhe ide palëve të treta. Neni 10 i Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoritete publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të vendosin regjim autorizimesh për sipërmarrjet e radiodifuzionit, të kinemasë ose të televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji dhe që, në një shoqëri demokratike përbejnë masa të nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetit territorial ose sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

I. PRANUESHMËRIA

A. Ankimi në bazë të nenit 6 të Konventës

49. Në kërkesën e tij fillestare, kërkuesi u bazua në nenin 6 të Konventës duke pretenduar se Gjykatat vendase nuk kishin marrë në konsideratë argumentet e sjelle prej tij në procesin ku ai kërkonte rikthimin në detyrë. Megjithatë, në parashitësat e tij të mëvonshme, kërkuesi kërkoi nga Gjykata që të mos vazhdojë me shqyrtimin e këtij pretendimi. Prandaj Gjykata nuk do ta shqyrtojë atë.

B. Ankimi në bazë të nenit 10 të Konventës

50. Qeveria nuk ka kontestuar vërtetësinë e letrës që ishte dërguar nga Z. Mişin Prokurorit të Përgjithshëm. Megjithatë, ata argumentuan se nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes, sepse ai nuk ishte autor i artikujve që ishin botuar në *Jurnal de Chişinău* dhe nuk ishte larguar nga detyra për shkak të ushtrimit të së drejtës së për lirinë e shprehjes, por thjesht pasi kishte shkelur rregulloret e brendshme të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas tyre, duke qenë se ankesa lidhej në thelb me të drejtat e punës të kërkuesit, neni 10 nuk zbatohet.

51. Kërkuesi argumentoi se neni 10 ishte i zbatueshëm në rastin në fjalë, pavarësisht nga fakti se ai nuk ishte autor i letrave që ishin dërguar në

gazetë. Duke u bazuar në rastet e *Thoma kundër Luksemburgut* (nr. 38432/97, ECHR 2001-III) dhe *Jersild kundër Danimarkës* (vendimi i datës 23 shtator 1994, Seria A nr. 298), ai parashtroi se Gjykata kishte gjetur tashmë se liria e shprehjes përfshinte edhe të drejtën për të përhapur informacionin e marrë nga palët e treta.

52. Gjykata rithekson se mbrojtja e nenit 10 shtrihet në vendin e punës në përgjithësi dhe të nëpunësve publikë, në veçanti (shih *Vogt kundër Gjermanisë*, vendimi i datës 26 shtator 1995, Seria A nr. 323, § 53; *Wille kundër Lihtenshtejnit* [GC], nr. 28396/95, § 41, ECHR 1999 VII; *Ahmed dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 2 shtator 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-VI, § 56; dhe *Fuentes Bobo kundër Spanjës*, nr 39293 / 98, § 38, 29 shkurt 2000).

53. Kërkuesi i dërgoi letrat gazetës, e cila më pas i botoi ato. Duke qenë se neni 10 përfshin lirinë për të dhënë informacione dhe gjithashtu duke mbajtur parasysh se kërkuesi u shkarkua nga detyra pikërisht për pjesëmarrjen e tij në botimin e letrave, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin paraprak të Qeverisë.

54. Gjykata vëren se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe ligjit, sipas nenit 10 të Konventës, dhe si i tillë duhet të shqyrtohet në themel dhe se nuk ka baza për ta deklaruar të papranueshme. Prandaj Gjykata deklaron të pranueshme kërkesën. Në përputhje me vendimin e saj për të aplikuar nenit 29 § 3 të Konventës (shih paragrafin 4 më lart), Gjykata do të shqyrtojë menjëherë themelin e këtyre ankesave.

II. THEMELI

A. Ekzistenca e një ndërhyrje

55. Gjykata gjeti në paragrafin 53 më sipër, se neni 10 ishte i zbatueshëm në çështjen në fjalë. Ajo më tej vlerëson se shkarkimi i kërkuesit për shkak të bërjes publike të letrave përbënte "ndërhyrje nga autoriteti publik", në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

56. Një ndërhyrje e tillë do të përbëjë shkelje të nenit 10, përveç nëse kjo ndërhyrje "parashikohet nga ligji", ndjek një ose më shumë qëllime të ligjshme sipas paragrafit 2 dhe është "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për arritjen e këtyre qëllimeve.

B. Nëse ndërhyrja ka qenë e "parashikuar nga ligji"

57. Në parashtrimet e tij fillestare, kërkuesi argumentoi se ndërhyrja nuk ishte parashikuar nga ligji, duke qenë se ligji në të cilën mbështeteshin autoriteteve vendase nuk ishte mjaftueshmërisht i parashikueshëm.

Megjithatë, në parashtrimet e mëvonshme me gojë ai nuk e ndoqi më këtë argument.

1. 58. Gjykata vëren se, kërkuesi u shkarkua nga detyra, bazuar në nenin 263/1 të Kodit të Punës pasi shkeli detyrimet e përcaktuara në paragrafët 1.4 dhe 4.11 e Rregullores së Brendshme të Departamentit të Shtypit e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm (shih paragrafin 31 më sipër). Megjithatë, duke qenë se palët nuk argumentuam më tej lidhur me këtë pikë para Gjykatës, ajo do të vazhdojë shqyrtimin e saj bazuar në supozimin se dispozitat e përfshira në paragrafët 1.4 dhe 4.11 të Rregullores së Brendshme përmbushin kërkesën që ndërhyrja të jetë e "parashikuar nga ligji".

C. Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim legjitim

59. Kërkuesi argumentoi se, ndërhyrja nuk ndjek ndonjë qëllim të ligjshëm. Qeveria parashtroi se qëllimet legjitime të ndjekura në këtë rast ishin ruajtja e autoritetit të gjyqësorit, parandalimi i krimit dhe mbrojtja e reputacionin të të tjerëve. Gjykata, nga ana e saj, është e gatshme të pranojë se qëllimi legjitim i ndjekur ishte parandalimi i bërjes publike të informacioneve të marra në besim. Duke gjykuar në këtë mënyrë, gjykata e konstaton të rëndësishëm faktin që në kohën e shkarkimit të tij, kërkuesi refuzoi të zbulojë burimin e informacionit, çfarë nënkupton se nuk ishte lehtësisht apo publikisht i aksesueshëm (shih *Haseldine kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18957 / 91, Vendim i Komisionit i datës 13 maj 1992, Vendimet dhe Raportet (VR) 73). Kështu, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, në veçanti nëse ka pasur një marrëdhënie proporcionale midis ndërhyrjes dhe qëllimit të ndjekur.

D. Nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike

1. Parashtrimet e palëve

(a) Kërkuesi

60. Sipas kërkuetit, zbulimi i letrave duhej të konsiderohet si denoncim i sjelljeve të paligjshme.

61. Ai vuri në dukje së pari faktin se ai kishte vepruar në mirëbesim dhe se, kur ai i përcolli letrat gazetës, ishte i bindur se ato përmbanin informacion lidhur me shkelje të rënda nga ana e Zv. Kryetarit të Kuvendit. Arsyeja e vetme e bërjes publike të letrave, ishte për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit dhe ushtrimit të influencës nga zyrtarët publikë. Ai kundërshtoi argumentin se qëllimi i shënimit nga Z. Mişin kishte qenë

thjesht për të kaluar letrën e policëve Prokurorit të Përgjithshëm në përputhje me Ligjin për Peticionet (shih paragrafin 38 më lart) dhe me pretendimin se veprimet e zotit Mişin kishte qenë në pajtim me nenet 22 dhe 23 të Ligjit për Statusin të Deputetëve (shih paragrafin 39 më lart). Ai më tej argumentoi se letrat nuk ishin pjesë e ndonjë dosjeje penale.

Kërkuesi pohoi se duke e parë në dritën e mënyrës në të cilën Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij emëroheshin dhe pozitën dominuese të Partisë Komuniste në Kuvend, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm perceptohej nga publiku si e ndikuar fort nga Kuvendi. Pavarësia e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm është e garantuar në teori por jo në praktikë. Në pohimet e kërkuesit thuhej gjithashtu se, Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohej nga Kuvendi pa ndonjë arsye. Në vitet 2002-2003 më shumë se tridhjetë prokurorët të cilët nuk ishin konsideruar besnikë të Partisë Komuniste ishin shkarkuar. Për më tepër, Z. Mişin, i cili ishte një nga udhëheqësit e partisë në pushtet dhe zëvendës kryetar i Parlamentit, perceptohej se në mënyrë sistematike përdorte pozitën e tij për të ndikuar në rezultatin e procedimeve gjyqësore.

Kërkuesi ka shtuar se gjuha e letrës së shkruar nga Z. Mişin pa mëdyshje tregon qëllimin e autori të saj për të ndikuar rezultatin e procedimeve penale kundër katër oficerëve të policisë. Një sjellje e tillë përbënte vepër penale sipas nenit 190/1 të Kodit Penal (shih paragrafin 33 më lart). Kërkuesi gjithashtu vuri në dukje faktin se pas marrjes së letrës në fjalë, Prokurori i Përgjithshëm kishte urdhëruar rihapjen e hetimeve penale dhe menjëherë pas kësaj këto hetime ishin ndërprerë. Sipas kërkuesit, fakti që katër oficerët e policisë vendosën t'u drejtoheshin përfaqësuesve të nivelin të lartë të shtetit për të hetuar ligjshmërinë e akuzave penale kundër tyre tregon për ekzistencën e një praktikë në Republikën e Moldavisë, që ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve. Nuk mund të mendohet që oficerët e policisë që merren me hetimet e krimeve, të mos jenë në dijeni se autoritetet të cilëve ata ju drejtuan, nuk kanë funksione gjyqësore.

Sipas kërkuesit, informacioni i bërë publik prej tij ishte kështu me interes të madh publik.

62. Në mënyrë që të bënte publik informacionin, ai nuk kishte alternativë tjetër përveç se t'i drejtohej një gazete. Legjislacioni për denoncuesit në Moldavi mungon dhe për këtë arsye punonjësit nuk kanë procedura të përcaktuara për të ndjekur në rastet kur vënë re veprime të jashtëligjshme në mjedisin ku punojnë. Do kishte qenë gjithashtu e pakuptimtë ta ngrinte problemin përpara Prokurorit të Përgjithshëm, duke qenë se këtij i mungonte pavarësia. Edhe pse ai kishte qenë në dijeni të letrës së Z. Mişin për rreth gjashtë muaj, e kishte fshehur ekzistencën e saj, dhe në të njëjtën kohë kishte vepruar në përputhje me porositë sipas saj. Refuzimi i Prokurorisë për fillimin e procedurës penale kundër Z. Mişin edhe pas publikimit të artikujve të gazetës (shih paragrafët 15 dhe 29 më lart) mbështesin argumentin e mësipërm se çdo përpjekje për trajtimin e

problemit Prokurorisë do kishte qenë e kotë. Për më tepër, kërkuesi kishte arsye për të pasur frikë se provat mund të fshiheshin ose shkatërroheshin nëse ai ia bënte ato të ditura eprorëve të tij.

Kërkuesi parashtroi gjithashtu se do të kishte qenë e paarsyeshme të pretendohet që ai të ankohej në parlament kur 71 nga 101 anëtarët e saj ishin nga Partia Komuniste dhe nuk kishte asnjë precedent që një deputet nga ajo parti të ndiqej penalisht për një vepër penale. Për më tepër, në periudhën 2001 dhe 2004, asnjë nismë nga opozita që ishte në kundërshtim me interesat e partisë në pushtet nuk ka qenë e suksesshme në Parlament.

63. Kërkuesi u ankua gjithashtu për ashpërsinë e sanksionit ndaj tij duke vënë në dukje se masa e marrë ndaj tij ishte e fundit në listën e dënimeve të tjera të mundshme që mund të vendoseshin.

(b) Qeveria

64. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, zbulimi i letrave në fjalë nuk përbënte informim.

65. Ata pohojnë se letrat ishin dokumentet e brendshme, për të cilat normalisht kërkuesi nuk do kishte mundësi të kishte dijeni për shkak të funksionit të tij. Ai efektivisht i kishte "vjedhur" ato. Për më tepër, letrat e publikuara nga kërkuesi ishin konfidenciale dhe pjesë e një dosje penale. Sipas kodit të procedurës penale, materialet e një dosjeje penale nuk mund të bëhen publike pa autorizimin e personit që kryen hetimin (shih paragrafin 35 më lart).

Mirëbesimi i kërkuesit ishte e diskutueshëm edhe për shkak se nuk kishte arsye të besohej se letra e shkruar nga z. Mişin të konsiderohej se vinte në presion Prokurorin e Përgjithshëm. Shprehja "unë kërkoj nga ju që të përfshiheni personalisht në këtë çështje për ta zgjidhur atë në përputhje të plotë me ligjin" ishte një formë normale e komunikimit midis organeve të ndryshme shtetërore, në përputhje me ligjin. Z. Mişin thjesht kishte kaluar letrën drejtuar tij prej katër oficerëve e policisë, organit kompetent - Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm - në përputhje me Ligjin për Peticionet (shih paragrafin 38 më lart) dhe Ligjin për Statusin e Deputetëve (shih paragrafin 39 më lart). Sipas këtij të fundit, një deputet ka të drejtë, *inter alia*, për të shqyrtuar peticione nga qytetarët, për t'ia kaluar ato autoriteteve kompetente, për të marrë pjesë në shqyrtimin e tyre dhe për të monitoruar zgjidhjen e tyre në pajtim me ligjin.

Nuk kishte asnjë lidhje shkakësore ndërmjet letrës e Z. Mişin dhe vendimit të mëvonshëm për të ndërprerë procesin penal kundër katër oficerëve të policisë. Në parashtrimet e saj, Qeveria shprehej se Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ishte një organ i pavarur, pavarësia e të cilit garantohet me Kushtetutën dhe me legjislacionin e Moldavisë (shih paragrafët 36 dhe 40 më lart).

Për më tepër, kërkuesi nuk kishte paraqitur përpara gjykatave të brendshme të njëjtat arsye për veprimet e tij me ato që i kishte paraqitur

punëdhënësit të tij (shih paragrafët 18 dhe 20 më lart). Sipas opinionit të Qeverisë, kjo gjithashtu tregonte një mungesë e veprimit në mirëbesim nga ana e tij dhe shpreh qartë se motivi i vërtetë nuk ishte lufta kundër korrupsionit, por një përpjekje për të vënë në pozitë të vështirë subjektet e prekura nga kjo çështje.

66. Përderisa, Z. Mişin nuk po përpiquej të ushtronte presion mbi Prokurorin e Përgjithshëm, siç u theksua dhe më sipër, informatat që gjenden në letrën e tij nuk ishin me interes publik.

67. Për më tepër, kërkuesi nuk i kishte zbuluar informacionet tek një autoritet kompetent dhe kishte vepruar me nxitim. Informacioni i nxjerrë, nuk ishte urgjent apo i një natyre që kishte pasoja të pakthyeshme lidhur me jetën, shëndetin ose mjedisin. Kërkuesi kishte të drejtë për të nxjerrë informacione jashtë, vetëm nëse nuk ishte e mundur për ta bërë këtë brenda institucionit. Normalisht kërkuesi, duhej t'i drejtohej niveleve të larta të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe më pas Parlamentit (përfshi komisionet parlamentare, fraksionet partiake dhe opozita), në vend që t'i drejtohej direkt shtypit.

Në mbështetje të parashtrimeve të tyre, qeveria i dërgoi Gjykatës kopje ankesash nga qytetarë drejtuar Parlamentit lidhur me paligjshmëri në punësim dhe çështje të tjera. Të gjitha ankesat janë përcjellë nga Parlamenti tek organet kompetente, të tilla si Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshilli i Lartë i Magjistraturës, pa përfshirje të mëtejshme të Parlamentit.

Qeveria argumentoi se njëzet e një shtete të Shtetet të Bashkuara të Amerikës nuk ofrojnë mbrojtje për deklaratimet e bëra në media, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar mbrojtja e denoncuesve publike bëhej vetëm në rrethana jashtëzakonisht të rralla dhe të përcaktuara në mënyrë rigoroze.

68. Në vet natyrën e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë, Shteti ka një hapësirë të madhe vlerësimit për të ndërhyrë në të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes. Së fundmi, Qeveria në lidhje me ashpërsinë e dënimit u shpreh, se ai ishte në proporcion me rëndësinë e veprimeve të kërkuesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

(a) Parimet e përgjithshme që zbatohen në këtë çështje

69. Problemi kryesor është të përcaktohet nëse ndërhyrja ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Parimet themelore në këtë drejtim janë të mirëpërcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës dhe janë të përmbledhura si më poshtë (shih, midis vendimesh të tjera, *Jersild kundër Danimarkës*, cituar më lart, f 23, § 31; *Hertel kundër Zvicrës*, gjykimi të datës 25 gusht 1998, Raportet 1998 VI, fq. 2329-30, § 46, dhe *Çeliku dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 68416/01, § 87, ECHR 2005 II):

“(i) Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për vetë përmbushjen e çdo individi të saj. Paragrafi 2 i nenit 10, është i zbatueshëm jo vetëm për ‘informacionin’ ose ‘idetë’ që konsiderohen të favorshme apo si të padëmshme apo si ndaj të cilave mund të jesh indiferent, por edhe për ato informacione apo ide që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Siç përcaktohet në nenin 10, kjo liri është subjekt i përjashtimeve, të cilat ... duhet, megjithatë, të interpretohen në mënyrë rigorozë, dhe nevoja për çdo kufizim duhet të përcaktohet bindshëm...

(ii) Termi “të nevojshme” sipas kuptimit që i jepet në nenin 10 § 2, nënkupton ekzistencën e një “nevoje të ngutshme sociale”. Shtetet kontraktuese kanë hapësirë për të vlerësuar se kur një nevojë e tillë ekziston, por kjo hapësirë vlerësimi i nënshtrohet mbikëqyrjes evropiane dhe përfshin legjislacionin dhe vendimet që e zbatojnë atë, madje edhe ato të dhënë nga një gjykatë e pavarur. Gjykata është e autorizuar pra, të japë vendimin përfundimtar nëse një “kufizim” është i pajtueshëm me lirinë e shprehjes të mbrojtur nga neni 10.

(iii) Detyra e Gjykatës, në ushtrimin e juridiksionit të saj mbikëqyrës, nuk është të zërrë vendin e autoriteteve kompetente kombëtare, por të vëzhgojë pajtueshmërinë me kërkesat e nenit 10 të vendimeve që autoritet kombëtarë marrin brenda hapësirës së tyre të vlerësimit. Kjo nuk do të thotë se mbikëqyrja është e kufizuar në konstatimin nëse shteti i paditur e ka ushtruar diskrecionin e tij në mënyrë të arsyeshme, me kujdes dhe në mirëbesim; ajo çfarë Gjykata bën është që të vlerësojë nëse cenimi i pretenduar i të drejtës parë në dritën e çështjes si një e tërë është “në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur “ dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për të justifikuar atë janë” relevante dhe të mjaftueshme “... Në këtë mënyrë Gjykata bindet nëse standardet e autoriteteve kombëtare janë në pajtim me parimet e mishëruara në nenin 10 dhe nëse është bërë një vlerësim i pranueshëm i rrethanave përkatëse të çështjes konkrete...”

70. Gjykata më tej rithekson se neni 10 zbatohet edhe në vendin e punës, dhe se nëpunësit civilë, siç është dhe kërkuesi, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes (shih paragrafin 52 më lart). Në të njëjtën kohë, gjykata është e ndërgjegjshme që punonjësit kanë detyrimin për besnikëri, maturi dhe konfidencialitet, veçanërisht në rastin e nëpunësve civilë që vetë natyra e shërbimit civil kërkon që një nëpunës civil të respektojë detyrimet e lart përmendura (shih *Vogt kundër Gjermanisë*, cituar më lart, § 53; *Ahmed dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, § 55, dhe *De Diego Nafria kundër Spanjës*, nr 46833/99, § 37, 14 mars 2002).

71. Duke qenë se misioni i nëpunësve civilë në një shoqëri demokratike është të ndihmojë qeverinë në kryerjen e funksioneve të veta dhe duke qenë se publiku ka të drejtë të pretendojë që ata do të ndihmojnë dhe të mos pengojnë qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike, detyra e besnikërisë dhe diskrecionit merr një rëndësi të veçantë për ta (shih, *mutatis mutandis*, *Ahmed dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, § 53). Përveç kësaj, në shkak të natyrës të punës së tyre, nëpunësit civilë shpesh kanë qasje në informata të cilat qeveria, për arsye të ndryshme legjitime, mund të ketë një interes në mbajtjen e tyre konfidenciale ose sekrete. Për sa

më sipër, detyrimi për diskrecion nga nëpunësit civilë është një detyrim i fortë që duhet respektuar prej tyre.

72. Deri më sot, megjithatë, gjykata nuk ka trajtuar çështje ku një nëpunës civil ka bërë publike një informacion të brendshëm. Çështja në fjalë ngre një problematikë të re të ndryshme nga ajo e ngritur në *Stoll kundër Zvicrës* ([GC], nr. 69698/01, 10 dhjetor 2007) ku zbulimi i informacionit u bë pa ndërhyrjen e një nëpunësi civil. Në lidhje me këtë, gjykata vëren se një nëpunës civil, në rrjedhën e punës së tij, mund të vihet në dijeni për informacione të brendshme, përfshirë informacione sekrete, nxjerrja apo publikimi i të cilave përbën një interes të fortë publik. Gjukata kështu çmon se, sinjalizimi nga një nëpunës civil ose një punonjës në sektorin publik për sjellje të jashtëligjshme ose jo të rregullta në vendin e punës, në rrethana të caktuara, duhet të gëzojë mbrojtje. Një mbrojtje e tillë i jepet punonjësi ose nëpunësit civil i cili është i vetmi person, ose pjesë e një kategorie të vogël të personash, të vetëdijshëm për atë që po ndodh në vendin e punës dhe të vetmit që mund të veprojnë në interes të publikut duke njoftuar punëdhënësin ose publikun e gjerë. Në këtë kontekst, Gjukata ka pasur parasysh deklaratën e mëposhtme nga Raporti shpjegues i Konventës Civile të Këshillit të Evropës për Korrupsionin (shih paragrafin 46 më lart):

“Në praktikë rastet e korrupsionit janë të vështira për t’u zbuluar dhe hetuar dhe punonjësit apo kolegët (publike ose private) të personave të përfshirë, janë shpesh personat e parë të cilët zbulojnë ose dyshojnë se diçka është e gabuar”.

73. Lidhur me detyrimin e punonjësve për konfidencialitet të përmendur më sipër, informohet së pari eprori ose ndonjë organ ose autoritet tjetër kompetent. Vetëm kur një gjë e tillë është qartësisht e pamundur, si alternativa e fundit duhet të konsiderohet bërja publike e informacionit (shih, *mutatis mutandis*, *Haseldine*, cituar më lart). Pra për të vlerësuar nëse kufizim mbi lirinë e shprehjes ishte proporcional, Gjukata duhet të shqyrtojë nëse kërkuesi ka pasur në dispozicion apo jo, mjete të tjera efektive për të informuar mbi aktet e parregullta që kishte vërejtur.

74. Në përcaktimin e proporcionalitetit të një ndërhyrje në lirinë e shprehjes të një nëpunësi civil, në një rast të tillë Gjukata duhet të ketë parasysh një sërë faktorësh të tjerë. Në radhë të parë, vëmendje e veçantë do t’i kushtohet interesit publik të përfshirë në informacionin e zbuluar. Gjukata rithekson se ka pak hapësirë në bazë të nenit 10 § 2 të Konventës për kufizime lidhur me debate mbi çështjet me interes publik (shih, midis vendimeve të tjera, *Sürek kundër Turqisë* (nr. 1) [GC], nr. 26682/95, § 61, ECHR 1999-IV). Në një sistem demokratik veprimet ose mosveprimet e qeverisë duhet të jetë subjekt i shqyrtimit nga afër, jo vetëm nga autoritetet ligjvënëse dhe gjyqësore, por edhe nga mediat dhe opinioni publik. Interesi që publiku mund të ketë për një informacion të veçantë nganjëherë mund të jetë aq i fortë sa për të shkelur edhe detyrim ligjor për konfidencialitet (shih *Fressoz dhe Roire kundër Francës* [GC], nr 29183/95, ECHR 1999 I.; Dhe *Radio Twist, AS kundër Sllovakisë*, nr. 62202/00, ECHR 2006 ...).

75. Faktori i dytë që lidhet me këtë analizë baraspeshimi është vërtetësia e informacionit të zbuluar. Autoritetet kompetente shtetërore, janë ato që duhet adoptojnë masat që synojnë tu përgjigjen siç duhet dhe jo më shume seç duhet, akuzave shpifëse të cilave u mungon themeli apo që bëhen me keqbesim (shih *Castells kundër Spanjës*, vendim i datës 23 prill 1992, Seria A nr. 236, § 46). Për më tepër, liria e shprehjes mbart me vete detyrimet dhe përgjegjësitë dhe çdo person i cili zgjedh të japë informacione për të verifikuar me kujdes, për aq sa rrethanat ia mundësojnë, nëse informacioni është i saktë dhe i besueshëm (shih, *mutatis mutandis*, *Morissens kundër Belgjikës*, nr. 11389/85, vendim i Komisionit i 3 Maj 1988, DR 56, p 127; dhe *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë* [GC], nr 21980/93, § 65, ECHR 1999-III).

76. Në anën tjetër të peshores, Gjykata duhet të peshojë dëmet, nëse ka të tilla, që autoriteti publik ka pasur, si rezultat i zbulimit të informacionit në fjalë dhe për të vlerësuar nëse dëme të tilla ishin mbizotëruese ndaj interesit të publikut (shih, *mutatis mutandis*, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, aktgjykimi i datës 16 dhjetor 1992, Seria A nr 252, § 45; dhe *Stoll kundër Zvicrës*, cituar më sipër, § 130). Në lidhje me këtë, objekti i çështjes së bërë publike dhe natyra e autoritetit administrativ përkatës mund të jenë të rëndësishme (shih *Haseldine*, cituar më lart).

77. Motivi që qëndron prapa veprimeve të punonjësit që raporton është një tjetër faktor përcaktues në marrjen e vendimit nëse një zbulimi i veçantë duhet të mbrohet apo jo. Për shembull një akt i motivuar nga një pakënaqësi ose armiqësi personale apo përfitime personale, duke përfshirë edhe ato materiale, nuk do të justifikonte një nivel veçanërisht të lartë mbrojtjeje (shih *Haseldine*, cituar më lart). Është e rëndësishme për të përcaktuar nëse individ i që ka zbuluar informacionin ka vepruar në mirëbesim dhe ka besuar se informacioni ishte i vërtetë, se ishte në interes të publikut që ta bënte atë publik dhe se nuk kishte mjete të tjera, më diskrete në dispozicion të tij apo të saj për të vepruar ndaj gjendjes së parregullsisë.

78. Së fundi, në lidhje me vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në lidhje me qëllimin legjitim të ndjekur, është e nevojshme të analizohet ndëshkimi i vendosur për kërkuesin dhe pasojat e këtij ndëshkimi. (shih *Fuentes Bobo*, cituar më lart, § 49).

79. Gjykata do të vlerësojë tani, faktet e çështjes në fjalë, në dritën e parimeve të mësipërme.

(b) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen në fjalë

(i) Nëse kërkuesi kishte mjete alternative për të bërë zbulimin e informacionit

80. Kërkuesi argumentoi se ai nuk kishte në dispozicion mjete të tjera efektive alternative për raportimin e informacionit që dispononte, ndërsa Qeveria kundërshtoi duke pohuar se, kërkuesi mund ta kishte ngritur

çështjen me eprorët e tij në fillim e më pas në Parlament apo tek Avokati i Popullit nëse do ishte e nevojshme.

81. Gjykata vëren se as Rregulloret e Brendshme të Zyrës së Prokurorit e as legjislacionin Moldav nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me raportimin e parregullsive nga punonjësit (shih paragrafin 32 më sipër). Pra, nuk kishte asnjë autoritet tjetër përveç eprorëve të kërkuesit, ku ai mund të raportonte shqetësimet e tij dhe asnjë procedurë të parashikuar për raportimin e çështjeve të tilla.

82. Gjithashtu del se, raportimi që kishte të bënte me sjelljen e Zëvendës Kryetarit të Kuvendit, i cili ishte një zyrtar i nivelit të lartë, dhe se pavarësisht se ishte në dijeni të situatës qysh prej gjashtë muajsh, Prokurori i Përgjithshëm nuk kishte treguar asnjë shenjë se kishte synim për t'u përgjigjur, por përkundrazi dha përshtypjen se ai i ishte nënshtruar presionit ndaj zyrës e tij.

83. Lidhur me format alternative për raportimin e parregullsive të sugjeruara nga Qeveria (shih paragrafin 67 më sipër), Gjykata konstaton se nuk është paraqitur ndonjë evidencë e kënaqshme për t'iu kundërvënë pretendimit të kërkuesit se asnjë nga alternativat e propozuara nuk do të kishte qenë efektive në rrethana të veçanta të rastit në fjalë.

84. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në rrethanat e çështjes aktuale raportimi i jashtëm, madje edhe në një gazetë, justifikohet.

(ii) Interesi publik në informacionin e bërë publik.

85. Kërkuesi parashtroi se shënimi i Z. Mişin përbënte dëshmi të ndërhyrjes politike në sistemin e drejtësisë. Qeveria kundërshtoi.

86. Gjykata vëren se letra e policëve i kërkon Z. Mişin për të verifikuar ligjshmërinë e akuzave penale kundër tyre nga Zyra e Prokurorit (shih paragrafin 10 më lart). Z. Mişin reagoi duke i dërguar një letër zyrtare Prokurorit të Përgjithshëm. Qeveria parashtroi se veprimet e zotit Mişin ishin në pajtim, *inter alia*, me Ligjin për Statusin e Deputeteve. Në këtë kontekst, Gjykata e konsideron të nevojshme të përsërisë se në një shoqëri demokratike si gjykatat ashtu dhe autoritetet e hetimit duhet të jenë të lira nga presioni politik. Çdo interpretim i ndonjë legjislacioni që përcakton të drejtat e Deputeteve duhet t'i përmbahet këtij parimi.

Duke shqyrtuar shënimin që Z. Mişin i dërgoi Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e sjellë nga Qeveria se, ai shënim kishte për qëllim jo më shumë se të përcillte letrën e oficerëve të policisë tek organi kompetent (shih paragrafin 65 më lart). Për më tepër, në kuadrin e kontekstit dhe të gjuhës së përdorur nga Z. Mişin, nuk mund të përjashtohet fakti se efekti i shënimit ishte për të ushtruar presion mbi Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, pavarësisht përfshirjes së fjalisë se çështja duhet të "shqyrtohet në përputhje të plotë me ligjin" (shih paragrafin 10 më lart).

87. Përkundrazi këtij sfondi, Gjykata vëren se Presidenti i Moldavisë ka bërë fushatë kundër praktikës së ndërhyrjes nga politikanët në sistemin e

drejtësisë penale dhe se media moldave e kanë trajtuar gjerësisht këtë temë (shih paragrafin 11 më lart). Ajo gjithashtu vë në dukje raportet e organizatave ndërkombëtare joqeveritare (shih paragrafët 40-42 më lart), të cilat shprehin shqetësim për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe mungesës së pavarësisë së gjyqësorit në Moldavi.

88. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se letrat e bëra publike nga kërkuesi trajtonin çështje të tilla si ndarja e pushteteve, sjellje të pahijshme nga ana e një politikani të rangut të lartë dhe qëndrim i Qeverisë ndaj brutalitetit të policisë (shih paragrafët 10 dhe 14 lart). Nuk ka asnjë dyshim që këto janë çështje shumë të rëndësishme në një shoqëri demokratike për të cilat publiku ka interes legjitim për t'u informuar në lidhje me to dhe që përfshihen brenda sferës së debatit politik.

(iii) *Vërtetësia e Informacionit të bere publik*

89. Është përgjithësisht e pranuar që letrat e publikuara nga kërkuesi në Jurnal de Chişinău ishin të vërteta. (shih paragrafin 26 më lart).

(iv) *Dëmi i shkaktuar Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm*

90. Gjykata vëren se është në interesin publik që ky i fundit të ruajë besimin në pavarësinë dhe neutralitetin politik të autoriteteve të ndjekjes penale të një shteti (shih, *mutatis mutandis*, *Prager dhe Oberschlick kundër Austrisë*, vendimi i datës 26 prill 1995, Seria A nr. 313, § 34). Letrat e dërguara nga kërkuesi për gazetën nuk ishin shkruar nga zyrtarët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, dhe sipas Qeverisë, letra e Z. Mişin ishte një komunikim normal ndërmjet organeve shtetërore dhe nuk kishte ndikuar në vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme për të pushuar procesin penal kundër oficerëve të policëve. Megjithatë, konkluzioni i nxjerrë nga gazeta në artikujt e saj se Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka qenë subjekt i ndikimit të padrejtë mund të ketë pasur efekte të forta negative në besimin e publikut në pavarësinë e këtij institucioni.

91. Mirëpo, Gjykata konsideron se interesi publikut për të pasur informacion në lidhje me presionet e panevojshme dhe të gabuara kundrejt Zyrës së Prokurorit është aq i rëndësishëm në një shoqëri demokratike sa është mbizotërues ndaj interesit për ruajtjen e besimit të publikut ndaj Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Ajo rithekson në këtë kontekst se, diskutimi i hapur i temave me interes publik është thelbësor për demokracinë dhe i duhet kushtuar rëndësi e madhe mos dekurajimit të publikut për të shprehur mendimet e tij mbi çështje të tilla (shih, *Barfod kundër Danimarkës*, vendimi i 22 shkurt 1989, Seria A nr. 149, § 29).

(v) *Nëse kërkuesi veproi në mirëbesim*

92. Kërkuesi argumentoi se motivi i tij i vetëm për bërjen publike të letrave ishte për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit dhe influencës nga zyrtarët e lartë. Kjo deklaratë nuk është kundërshtuar nga punëdhënësi i

tij. Qeveria, nga ana tjetër, shprehu dyshime nëse kërkuesi kishte vepruar në mirëbesim, duke argumentuar, *inter alia*, se ai nuk kishte dhënë këtë argumentim para gjykatave kombëtare.

93. Mbi bazën e materialeve paraqitur para saj, Gjykata nuk ka gjetur asnjë arsye për të besuar se kërkuesi ishte i motivuar nga dëshira për përfitime personale, për shkak të pakënaqësive personale kundrejt punëdhënësit të tij apo Z. Mişin, apo për motive të tjera të fshehta, në veprimet e tij. Fakti që ai në parashtrimet e tij para gjykatave vendase nuk ishte referuar luftës kundër korrupsionit dhe influencës nga zyrtarët e lartë është, sipas mendimit të Gjykatës, është argument jo bindës, pasi ai mund të ketë qenë i fokusuar në arsyetimin e paraqitur nga punëdhënësi i tij për shkarkimin e tij dhe e ka konsideruar të panevojshme për t'iu referuar çështjeve që punëdhënësi i tij nuk ka i ka ngritur për diskutim.

94. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se motivet e kërkuesit janë ato të deklaruara prej tij dhe se ai ka vepruar në mirëbesim..

(vi) *Ashpërsia e sanksionit*

95. Së fundi, Gjykata vëren se sanksioni i vendosur ndaj kërkuesit ishte më i ashpër. Ndërkohë që autoritetet kishin mundësi të zbatonin një sanksion më pak të ashpër, ata zgjedhën ta shkarkonin kërkuesin, padyshim kjo një masë shumë e ashpër (shih *Vogt*, cituar më lart, § 60). Ky sanksion nuk ka pasur vetëm pasoja negative për karrierën e kërkuesit, por ai gjithashtu mund të ketë një ndikim negativ tek punonjësit e tjerë nga Zyra e Prokurorisë dhe t'i dekurajojë ata nga raportimi i sjelljeve të parregullta. Për më tepër, duke marrë parasysh mbulimin mediatik që pati çështja e kërkuesit, sanksioni mund të ketë një efekt negativ jo vetëm për punonjësit e Zyrës së Prokurorisë, por edhe tek nëpunësit civilë dhe të punësuar të tjerë.

96. Gjykata vëren se Qeveria ka argumentuar se kërkuesi në fakt e kishte "vjedhur" letrën, e cila sipas tyre ishte sekrete dhe pjesë e një dosje penale. Qeveria gjithashtu ka deklaruar se, letra e zotit Mişin nuk kishte ushtruar asnjë presion mbi Prokurorinë. Ajo përbente një komunikim normal ndërmjet organeve shtetërore dhe nuk kishte lidhje me vendimin për të ndërprerë procesin penal kundër policëve. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se është e vështirë për të justifikuar zbatimin e një sanksioni të tillë të rëndë.

(c) **Përfundimi**

97. Duke qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e të drejtës së lirisë së shprehjes për çështjet me interes të përgjithshëm, të së drejtës së nëpunësve civilë dhe të punësuarve të tjerë për të raportuar sjelljen e paligjshme dhe parregullta në vendin e tyre të punës, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve ndaj punëdhënësve të tyre dhe të drejtën e punëdhënësve për të menaxhuar stafin e tyre, dhe pasi u peshuan interesat të tjera të ndryshme të përfshira në çështjen në fjalë, Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e

kërkuesit për lirinë e shprehjes, në veçanti të drejtën e tij për të dhënë informacion, nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

98. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

99. Kërkuesi pretendoi 15000 euro në lidhje me dëmin material dhe jo material, përkatësisht: 6000 euro për të ardhurat e munguara gjatë periudhës së papunësisë pas shkarkimit të tij, 6000 euro për humbjen e perspektivës së karrierës dhe 3000 euro për dëmin jo material.

100. Qeveria kundërshtoi pretendimin e kërkuesit si të pabazuar dhe të tepruar.

101. Gjykata çmon se kërkuesi duhet të ketë pësuar dëme materiale dhe jo materiale si rezultat i shkarkimit të tij. Duke bërë vlerësimin mbi baza të barabarta, Gjykata i jep atij 10000 euro.

B. Kosto dhe Shpenzime

102. Përfaqësuesit e kërkuesit pretenduan 6,843 euro për tarifat ligjore, nga të cilat 4,400 euro për Z. Gribincea dhe 2,443 Euro për Z. Zamă. Ata paraqiten bilancin kohor dhe një kontratë që tregonte se tarifat për orë respektivisht ishin 80 euro dhe 70 euro. Llogaritja në bilancin kohor nuk përfshinte kohen e kaluar në ankesën sipas nenit 6, i cili u tërhoq më vonë nga kërkuesi.

103. Ata argumentuan se numri i orëve që kishin kaluar në lidhje me këtë çështje nuk ishin të tepruar dhe justifikoheshin nga kompleksiteti i çështjes dhe faktin se parashtrimet duheshin shkruar në gjuhën angleze.

104. Për sa i përkiste tarifave për orë, avokatët e kërkuesit argumentuar se ato ishin brenda kufijve të rekomanduar nga Shoqata Moldave e Avokatëve, që varionin nga 40 deri në 150 euro.

105. Përfaqësuesit e kërkuesit gjithashtu pretenduan 2,413 euro për shpenzimet e lidhura me seancën e 6 qershorit 2007, shumë e cila përfshin shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e vizave, shpenzimet e sigurimit dhe një shumë për shpenzime të tjera të domosdoshme.

106. Qeveria e kundërshtoi shumën e pretenduar për përfaqësimin e kërkuarit. Ata thanë se ajo ishte e tepërt dhe kontestuan numrin e orëve që ishin shpenzuar nga avokatët e kërkuarit dhe tarifat për orë, veçanërisht atë të Z. Zamă., i cili, sipas mendimit të tyre, nuk kishte përvojën e nevojshme për të pretenduar tarifa të tilla të larta.

107. Sa i përket shpenzimeve të tjera të pretenduara nga kërkuari, Qeveria argumentoi se ata duhet të pretendoheshin nga Gjykata.

108. Gjykata rithekson se që kostot dhe shpenzimet të përfshihen në shumën që jepet sipas nenit 41 të Konventës, ato duhet të jenë të vërteta dhe të kenë qenë të domosdoshme dhe ishin të arsyeshme në masë (shih, për shembull, *Amihalachioaie kundër Moldavisë*, nr. 60115/00, § 47, ECHR 2004 - III). Në rastin konkret, duke pasur parasysh në listën e detajuar që është dorëzuar dhe kompleksitetin e çështjes, Gjykata jep tërë shumën e pretenduar nga Z. Gribincea, 1,600 euro për tarifën e Z. Zamă dhe tërë shumën e pretenduar nga përfaqësuesit të kërkuarit për shpenzimet e bëra në lidhje me seancën e 6 qershor 2007.

C. Interesi i mospagimit

109. The Court considers it appropriate that the default interest should be based on the marginal lending rate of the European Central Bank, to which should be added three percentage points.

PER KETO ARSYE, GJYKATA NJEZËRI

1. *E deklaron* ankesën të pranueshme;
2. *Vendos* se ka pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës;
3. *Vendos*
 - (a) Se, Shteti i paditur, duhet t'u paguaje kërkuarve së bashku, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 10000 euro (dhjetë mijë euro) për demin material dhe jo material, 8413 euro (tetë mijë e katër qind e trembëdhjetë euro) për kostot dhe shpenzimet, të cilat duhen konvertuar në monedhën vendase të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e pagesës, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e zbatueshme;
 - (b) Se, që nga mbarimi i afatit tre mujor deri në ditën e pagesës, do të zbatohet interesi i thjeshtë mbi shumën e mësipërme, në një përqindje të barabartë me përqindjen ditore të huadhënies nga Banka Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë përqindje;

4. *Hedh poshtë* pjesën e mbetur të pretendimeve të kërkuesve për shpërblim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar ne seancën publike më 12 Shkurt 2008, në Pallatin e të Drejtave të Njeriut, Strasburg.

Erik Fribergh
Kancelar

Jean-Paul Costa
President

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012.

Ky përkthim u bë i mundur me mbështetjen e Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (www.coe.int/humanrightstrustfund). Ai nuk është detyrues për Gjykatën dhe kjo e fundit nuk ka përgjegjësi për cilësinë e përkthimit. Ai mund të shkarkohet nga baza e të dhënave të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, HUDOC (<http://hudoc.echr.coe.int>), ose nga çdo bazë tjetër të dhënash të cilës Gjykata ia përcjell. Ai mund të riprodhohet për qëllime jo fitimprurëse me kushtin e përdorimit të titullit të plotë të çështjes, të dhënat e së drejtës së autorit dhe referencat përkatëse të Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut. Nëse pjesë të këtij përkthimi do të përdoren për qëllime fitimprurëse, ju lutem kontaktoni: publishing@echr.coe.int.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012.

This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). It does not bind the Court, nor does the Court take any responsibility for the quality thereof. It may be downloaded from the HUDOC case-law database of the European Court of Human Rights (<http://hudoc.echr.coe.int>) or from any other database with which the Court has to share it. It may be reproduced for non-commercial purpose on condition that the full title of the case is cited, together with the above copyright indication and reference to the Human Rights Trust Fund. If it is intended to use any part of this translation for the commercial purpose please contact publishing@echr.coe.int.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012.

La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). Elle ne lie pas la Cour, et celle-ci décline toute responsabilité quant à sa qualité. Elle peut être téléchargée à partir de HUDOC, la base de jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme (<http://hudoc.echr.coe.int>), ou de toute autre base de données à laquelle HUDOC l'a communiquée. Elle peut être reproduite à des fins non commerciales, sous réserve que le titre de l'affaire soit cité en entier et s'accompagne de l'indication de copyright ci-dessus ainsi que de la référence au Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme. Toute personne souhaitant se servir de tout ou partie de la présente traduction à des fins commerciales est invitée à le signaler à l'adresse suivante: publishing@echr.coe.int.